

MBI DHORA LEKËN DHE RRUGËTIMIN E SAJ MUZIKOR

Për ata që dinë mbi Dhora Lekën, vlen të ri-përmendim se ajo ka qenë gruaja–kompozitore me karrierën më të gjatë artistike në Shqipëri. Por karriera e saj ishte e ndryshme nga ajo e kompozitorëve të tjerë. Ajo pati një karrierë më së shumti mbijetese, ku muzika mbizotëroi mbi mundimet e saj panumërta, mundime fizike, psikike, poshtëruese, denigruese e përçmuese. Ja që forca e muzikës e bën njeriun, e bëri Dhorën, të mbijetojë dhe përmes saj të shprehë ndjesitë vetiake, sa spontane aq dhe të sinqerta e të vetëdijshme.

Pasionin e saj krijues Dhora e shprehu më së pari me thurjen e këngëve partizane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Këngët “Britma e çlirimit”, “Hakmarrje rini”, “Kënga e dëshmorëve të vëllazërimit” e shumë të tjera ishin produkt i luftës, që Dhora ua mësonte partizanëve, por që u futën edhe në repertorin e këngëtarëve lirikë shqiptarë që më 1946 (shih programin poshtë). Pra u krijuan si këngë pa nota të shkruara në pentagram, që kompozoheshin e mësoheshin gojë më gojë, dhe që gradualisht nisën të shkruhen edhe me nota muzikore. Për hedhjen në nota, nga të parët që e ndihmoi kompozitoren idealiste ishte Boris Plumbi edhe pse familja e tij nuk ishte e lidhur me lëvizjen nacional-çlirimtare. Janë të shumta këngët që diheshin si të Dhora Lekës por që me dekada të tëra nuk u njohën si të sajat nga regjimi totalitar në Shqipëri. Ato u kthyen në këngë anonime ashtu siç janë një mori këngësh popullore që dikur kanë pasur një autor të tyrin.

E lidhur fort me muzikën, pas luftës Dhora nisi punën në Radio Tirana ku programet muzikore që ajo ndërtonte ilustrroheshin përmes diqeve 78 rpm që ishin arkivuar në Radio që nga koha e Italisë. Kur vajti të studiojë muzikë në Moskë më 1948, e pikërisht në konservatorin “Çajkovski”, Dhora me një kitarë në dorë këndoi përpara komisionit të pranimit disa nga këngët e saj të luftës. Notat muzikore dhe partiturat ishin të huaja për të, gjë që e konstatuan që në krye anëtarët e komisionit kur ja vunë përpara për t’i lexuar. Ndër ato pak pyetje që ata i bënë ishte se përse ke ardhur këtu? “Uçitsa” (të mësoj) – iu përgjigj Dhora. Juria me zemërgjerësi e pranoi këtë përjashtim unikal të një studenteje që aspironte të bëhej kompozitore. Në mbarim të konservatorit më 1953, diplomën e mbrojti me kantatën “Shqipëri, atdheu im”, të cilën e ekzekutoi kori me Orkestrën Simfonike të Radio Moskës. Kthimi në Shqipëri po atë vit e gjeti Dhorën pedagoge në djepin e muzikës shqiptare, Liceun Artistik. Jepte lëndën e harmonisë dhe literaturës muzikore. Kam qenë edhe unë në këtë shkollë gjatë kohës që jepte mësim Dhora. E mbaj mend portretin e saj por që ende nuk e kisha arritur moshën të dëgjoja lëndët muzikore që ajo jepte. Pastaj mësuam se diçka ndodhi me të dhe nuk e pashë më në shkollë. Kush e mendonte se jeta e saj do të merrte një drejtim aq të vështirë, aq të pabesueshëm. Natyrisht përhapeshin lajme si “armike”, madje nxënësit e Sheq-Marinëzit në Myzeqe gjatë ditëve të vështira të internimit e tregonin me gisht në rrugë “Ballistja, ballistja”! Ndërkaq, po gjatë internimit të saj në Gjirokastrë, ajo u familjarizua edhe me këngën polifonike tradicionale dhe e vuri atë në nota, proces ky aspak i lehtë qoftë edhe për ata që janë marrë me lëvrimin e notëzimit të kësaj kënge. Gjithnjë në internim ajo shkroi, siç pohon vetë, “këngë, romanca, por mbi të gjitha poemën vokale-simfonike “Mbeç more shokë, mbeçë”. Shkrova dhe të parat vargje siç ishin “E mbyllën kanarinën në kuvli” – kujton Dhora.

Pas daljes nga burgu jetoi në Berat dhe pikërisht në këtë qytet shkroi ëndrrën e saj, operën “Këngë në shtrëngatë”. Por edhe vargjet poetike thuajse më të shumta të saj i shkroi në internim. Internimi, ky “burim frymëzimi, bëri që ajo të shkruajë operën e dytë të saj, “Maleve për liri”, kushtuar heroinës Zonja Çurre. Me gjithë jetën e gjatë të internimit, Dhora punën krijuese nuk e ndërpreu asnjëherë, “as edhe një ditë të vetme” – siç shprehet ajo vetë.

Pas viteve 1990 ajo filloi të marrë pak frymë lirie. Njerëzit nisën ta çmonin veprën e saj, personaliteti po vihej në vend, aq sa qe e mundur. Shkoi në Gjermani më 1992 ku takoi pas 52 vjetësh shokun e klasës në Konservator, violinistin me famë Mark Llubocki, i cili organizoi një takim-koncert për të, në Horschule të Hamburgut. Presidentja e Shoqatës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Artistëve të Persekutuar, Sybyla Ahlers, e mbështeti së tepërmi Dhorën. Falë kësaj zonje, edhe vajza ime, Teuta, soprano, dhe baritoni gjerman Hubert Wild, në nder të Dhorës ideuan një koncert, i cili u dha në Tiranë me Orkestrën Simfonike të Radiotelevizionit më 18 shtator 2004, pra 21 vite më parë. Veç pjesëve operistike që të dy solistët kënduan, në program u përfshinë edhe disa nga veprat më të spikatura të Dhora Lekës. Po i citoj: Uverturë orkestrale (premierë absolute), romanca “Ankohem nga një plep” – kënduar nga baritoni Hubert Wild, romanca tjetër “Si ujët e dliërë” – kënduar nga sopano Teuta Koço, si dhe dueti “Mesazh paqje dhe lirije” – kënduar nga Teuta dhe Huberti.

Nuk kanë qenë të paktë artistët që vuajtën në sistemin afër gjysmë-shekullor totalitar, por rasti i kompozitores Dhora Leka është i përveçëm, jo vetëm se ka qenë e para grua kompozitore, se dënimi i saj ka qenë nga më të gjatët mes artistëve (burg e internim), por edhe pse zhgënjimi i saj për atë që ëndërroi e luftoi gjatë Luftës II Botërore fatkeqësisht nuk ishte një përjashtim. Të tilla zhgënjime pati në disa qindra, në mos mijëra, familje shqiptare. Mjaft kuptimplotë është biseda e Dhorës me dirigjentin e Ansamblit të Ushtrisë, artistin fort të respektuar, Gaqo Avrazin: “Gaqo, kur isha e dënuar, të gjitha këngët e mia partizane transmetoheshin gjithandej, por emri im nuk përmendej kurrë. Tashti që emri im përmendet, këngët partizane dhe marshet partizane nuk transmetohen më!!! Ç’i thua ti kësaj?”.

Natyrisht që pyetja e Dhorës do të donte shpjegim. Këngët e marshet partizane sado të bukura të jenë a janë, ato, jo rrallë, janë perceptuar si të lidhura me një kohë e sistem të caktuar, atë sistem që i shkatërroi jetën edhe vetë Dhorës. Shkrimtari dhe gazetari francez Jacques Mallet du Pan (1749–1800) ka lënë të shkruar se “ashtu si Saturni, Revolucioni gllabëron fëmijët e tij”. Është natyrisht një deklaratë metaforike, por që nxjerr në pah idenë se lëvizjet revolucionare shpesh mund të çojnë në rënien ose shkatërrimin e atyre që fillimisht i mbështetën dhe morën pjesë në to (si ai miti i perëndisë romake Saturn, që nga frika se mos fëmijët e tij do ta rrëzonin, i kollofiti/hëngri ata). Jo pak herë revolucionet janë të prirë t’i përpijnë fëmijët e tyre, sepse sapo arrihet çështja e menjëhershme e përmbysjes së sistemit të mëparshëm, njerëzit e përfshirë në atë përmbysje priren të fillojnë të kuptojnë, se ata nuk paskan pasur ide të njëjta apo të ngjashme, se si do duhej bërë ky zëvendësim sistemi shoqëror e politik.

Pavarësisht nga aksioma e mësipërme, një gjë është bindëse, se qëndrimi i pushtetit totalitar me ingranazhet e tij ndaj Dhorës ka qenë tejet denigrues, i pashembullt në historinë muzikore shqiptare të pas-Luftës së Dytë Botërore. Nga ana tjetër, forca e dashuria e Dhorës për muzikën e bëri atë të fortë për të treguar se muzika është e vetmja gjë që depërton e pafiltruar në shpirt, dhe që shpirti dihet se përbëhet nga mendja e njeriut, pra janë mendimet ato që të bëjnë të arsyetosh. Kësisoj, duke qenë se muzika shëron shpirtin, tingulli bëhet po aq i fuqishëm sa dhe vetë Perëndia.

V. F. · L. P. THEATËR "KOSOVA,,

**FESTIVAL MUZIKOR
DHE KOREOGRAFIK**

= E Mërkurë 24 Prill 1946 - ora 20 =

Marrin pjesë

Sopr. **TEFTA TASHIKO KOÇI**

Sopr. **GJYZE KOSTURI**

Përfjall në PIANO

TONIN GURAZIU

Koreografi në

LOLA GJOKA-ALEKSI

PERSONI TREBICKA

P R O G R A M I

PJESA E I-të

- 1) VALLJA E ZJARRIT. Drejt. F. Trebicka
- 2) MOZART. Dasma e Figaros.
Duet për dy soprano
Tefta T. Koço—Gjyze Kosturi
- 3) MASCAGNI. Cavalleria Rusticana . . .
aria e Santuzza-s
Gjyze Kosturi
- 4) MEYERBUR. Dinoroli
aria Tefta T. Koço
- 5) VERDI. Fuqija e Fatit.
aria Gjyze Kosturi
- 6) MOZART. Rrembimi në Serraj
aria e Kostances
Tefta T. Koço
- 7) MOZART. Cosi fan tutte.
duet për dy soprano
Tefta T. Koço—Gjyze Kosturi
- 8) VALLE BULLGARE. Drejt. F. Trebicka

PJESA E II-të

- 1) VALLE RUSE. Drejt. Lola Gjoka-Alekxi

Këngë popullore dhe partizane

- 2) a) Dashtnuer t'u bana } Gjyze Kosturi
b) Karajfilat që ka Shkodra. . . }
- 3) a) As aman o syr' i zi } Tefta T. Koço
b) Ma ven doren përmi dorë . . }
- 4) a) Kënga e Qemal Stafes. } Gjyze Kosturi
b) Kënga e dëshmorëve. }
të vëllozërimit. (Muzikë Dh. Leka)
- 5) a) Kënga dëshmorëve të Pojkës } Tefta T. Koço
(Muzikë Prof. Sotir Paparisto)
b) Britma e clirimit }
(Muzikë Dh. Leka—Harm. Kristo Kono)
- 6) VALLE ARABE Drejt. Lola Gjoka-Alekxi

Marin pjesë në koreografi:

Lili Tirana, Juliana Prifti, Vera Toto, Rita Koka, Filomena Nishko, Jalldis Begeja, Hamide Stringa, Gjusepina Guga, Rina Mosi

I shoqëron grupi i amatoreve



Londër, 2004

